



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:326947
Datë: 12.12.2024
Numri i dokumentit: 06588671

C.nr.3967/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin Blerim Istrefi dhe me praktikanten e kësaj gjykate Albina Fazliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M. nga Mitrovica, të cilin sipas prokurës më shkrim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Klinaku & Associates, më seli në Komunën e Mitrovicës, kundër të paditurës SHSUK-Spitali i Përgjithshëm “Dr. Sami Haxhibeqiri”, të cilën sipas prokurës më shkrim e përfaqëson Laura Nushi dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, të cilën sipas prokurës më shkrim e përfaqëson Avokatura Shtetërore, më seli në ish objekti i Rilindjes, Komuna e Prishtinës. Objekt kontesti “Kompensim e te ardhurave nga marrëdhënia e punës”, jashtë seance gjyqësore, më datën 12.12.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A.M. nga Mitrovica, me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura SHSUK-Spitali i Përgjithshëm “Dr. Sami Haxhibeqiri” dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, që në emër të kompensimit e shtesës në pagë-shujtës mujore, prej datës 06.02.2023 deri më datë 30.08.2024, për 19 muaj, nga 45.76 euro muaj t’ia kompensoj shumë prej 869.44 Euro (më fjalë: tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e dyzet e katër cent), të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të detyrimit, të gjitha në afat 7 ditor nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. Secila palë vetë i bartë shpenzimet e procedurës.
- III. **OBLIGOHET** paditësi A.M. nga Mitrovica, që në emër të taksës gjyqësore për padi, të ja kompensoj gjykatës shumë prej 20 euro, në llogarin bankare nr. 1000430070000518 BK-BQK, në afat 15 ditor nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 13.10.2024, ka paraqitur padi, kundër të paditurave për kompensim material në emër të shtesës në pagë-shujta mujore në vlerë prej 45.76 Euro. Në padi ka theksuar se paditësja që nga data 06.02.2023, kur ka hyrë në fuqi Ligji për Paga në Sektorin Publik LIGJI Nr.08/L-196, i është ndërprerë shtesa në pagë/shujta mujore siç parashihet në deklaratën e përbashkët të Ministrit të Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës nr. 122/08, dt. 16.10.08 dhe vendimin nr. 05/24 dt. 05/24 dt. 12.01.2018 i datës 29.08.2008 i nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e drejtë kjo e

fituar në bazë të kontratës së punës. Padiësja vlerëson se me nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese me nr. Ref.: AGJ 2316/24, i datës 23.01.2024, duhet t'i njihet e drejta për shtesën në pagë/shujta mujore pasi që ky Aktgjykim në dispozitivin e tij, ka shpallë të pavlefshëm nenin 45 par.2 të këtij Ligji e si rrjedhojë vlerësojnë se duhet të vazhdohet me kompensimin në emër të shtesës në pagë/shujte mujore për periudhën nga data 06.02.2023 e tutje, dhe meqenëse palët nuk e kanë kompensuar shtesat në pagë/shujtat mujore paditëses. Padiësja i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe të detyrohen të paditurat që paditëses në emër të kërkesës mbi bazën e shtesës në pagë/shujtës mujore, për periudhën 06.02.2023 deri 30.08.2024, për secilin muaj nga 45.76 euro, e për 19 muaj shumen totale: 869.44 euro, me kamatë ligjore prej 8%, ashtu që kamata të paguhet duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, këto detyrime të paditurat t'i përmbushin brenda afatit prej 15 ditësh që nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura e parë SHSUK – Spitali i Përgjithshëm “Dr. Sami Haxhibeqiri” – Mitrovicë, me datë 11.12.2024 ka paraqitur përgjigje në padi, duke e kontestuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Ka theksuar se në bazë të shkresave të lëndës, vërehet se paditëses i mungon baza ligjore, për shkak se padiësja kërkesën e tij e ka bazuar në Deklaratën e përbashkët të Ministrisë të Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës nr. 122/08, dt.16.10.08 dhe vendimin nr. 05/24 dt. 05/24 dt. 12.01.2018 i datës 29.08.2008 i nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, mirëpo në deklaratën e lartcekur respektivisht në përmbajtjen e saj askund nuk ceket kompensimi i punëtorëve në emër të ushqimit – shujtës mujore, ashtu siç është pretenduar nga ana e paditëses. Më tutje deklaroi se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, është krijuar një sistem i njëtrajtshëm i pagave në sektorin publik, ku përfshihen edhe nëpunësit e sistemit shëndetësor, pra me këtë ligj është përcaktuar paga bazë edhe për nëpunësit e sistemit shëndetësor, e cila i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozite apo gradë që do të thotë se nga hyrja në fuqi e këtij ligji në mënyrë të hollësishme është rregulluar edhe çështja e pagës dhe çështjet tjera të të drejtave që ju takojnë, në këtë rast edhe punëtorëve shëndetësor, ku në mënyrë decedive është rregulluar me nenin 33 të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik nr. 08/L-196, janë të përcaktuara shtesat funksionale për nëpunësit e sistemit shëndetësor, e cila dispozitë ligjore është në fuqi ngase nuk është shfuqizuar me aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat kërkojmë nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, ta refuzojë në tërësi si të pabazuar dhe të pathemeltë, pasi që pretendimet e paditëses nuk kanë mbështetje ligjore.

E paditura e dytë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike(MPBAP), në Prishtinë, përmes Avokaturës Shtetërore me datën 11.12.2024, ka paraqitur përgjigje në padi, duke e kontestuar në tërësi si të palejuar kërkesëpadinë e paditëses. Ka theksuar se në bazë të shkresave të lëndës, shihet se e paditura nuk ka legjitimitet real pasiv, ngase përgjegjës është e paditura SHSUK – Spitali i Përgjithshëm “Dr. Sami Haxhibeqiri” – Mitrovicë, e cila është e pavarur dhe ka kodin e vet buxhetor që i është ndarë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike(MPBAP), andaj, edhe nuk përfaqësohet nga MPBAP. Ka shtuar se Avokatura Shtetërore nuk e përfaqëson SHSKUK dhe se kjo e fundit i ka përfaqësuesit e vet. Nga këto arsye, i ka propozuar Gjykatës që për përgjigje në padi dhe për përfaqësim në seancë të ftohen përfaqësuesit e SHSKUK-së.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimin të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor mbi refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses pa caktuar fare seancë gjyqësore, në kuptim të dispozitës nga neni 399 par.1 dhe 2 të LPK-së, e cila përcakton: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësja, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykatës i rezulton se paditësi është në marrëdhënie të punës me të paditurën e parë SHSUK – Spitali i Përgjithshëm “Dr. Sami Haxhibeqiri” – Mitrovicë dhe atë në bazë të kontratës së punës të datës nr. Prot.23/9, e datës 28.12.2012, e lidhur mes ndërgjyqësve, nga e cila rezulton se paditësi është i sistemuar në pozitën Teknik Laborant i Biologjis në Spitalin e Përgjithshëm - Mitrovicë, dhe nga kontrata dhe lista e pagave vërtetohet se ka pagë neto 563.45 €, si dhe gjithsej 30 vite përvojë pune.

Fakti vendimtar për tu vërtetuar nga ana e Gjykatës në këtë çështje juridike kontestimore, konsiston në vlerësimin e faktit nëse paditësit i takon e drejta në pagë/shujtën mujore, si dhe në rastin konkret e paditura e dytë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike a ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore.

Fillimisht, duhet përqendruar vëmendjen tek fakti se sa i përket kërkesës së paditësit për pagesën e shujtave mujore, gjykata gjen se kërkesa e paditësit mbështetet në Deklaratën e përbashkët të Ministrisë të Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës nr. 122/08, dt. 16.10.08. Nga vlerësimi i kësaj deklarate, gjykata konstaton se kjo deklarate nuk e ka fuqinë e aktit ligjor apo nënligjor dhe nuk paraqet dokument detyrues për të paditurën. Kjo nënkupton se, pavarësisht marrëveshjes mes palëve të përfshira, Deklarata nuk ka kaluar procesin e nevojshëm të miratimit ligjor dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret si dokument ligjor detyrues. Gjykata, duke vlerësuar bazën juridike të kësaj pjese të kërkesëpadisë, konstaton se çdo pretendim për kompensim duhet të mbështetet në një bazë të vlefshme juridike, dhe së këndejmi e paditura nuk mund të detyrohet të përmbushë një kërkesë mbi bazën e një deklarate që nuk ka peshën e një akti ligjor apo nënligjor të miratuar sipas kërkesës përkatëse. Për më tepër Ligji për pagat në sektorin publik në nenin 30 (Shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor) ka përcaktuar shtesat për nëpunësit e sistemit shëndetësor dhe njëkohësisht ka përcaktuar edhe kushtet për përfitimimin e këtyre shtesave, e që për pasojë, gjykata ka konstatuar se shtesa e pretenduar për shujta nuk hyn në kategorinë e shtesave.

Lidhur me vendimin e datës me numër 05/24, datë 12.01.2018, gjykata vëren se me këtë vendim janë ngritur pagat e nëpunësve të shërbimit shëndetësor, ashtu që në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi përcaktohet “Miratohet rritja e pagave duke filluar nga data 01 Janar 2018 për të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin paga nga buxheti i Republikës së Kosovës prej 4% ... si dhe 44 Euro për punëtorët shëndetësor.”, në rastin konkret këtu kemi pasur ngritje në pagë e jo vendim lidhur me shtesat në page-shujta mujore sikurse është përcaktuar në kërkesëpadinë e paditësit. Andaj, lidhur me këtë vendim mbi të cilin e ka mbështetur kërkesën paditësi gjykata konsideron se nuk mund të kërkohet shujta mujore, nga një vendim i cili është vendosur vetëm sa i përket rritjes së pagës prej 4%, apo në vlerë prej 44 euro, në emër të shërbyesve shëndetësor.

Tutje, me datë 05.02.2023, ka hyrë në fuqi Ligji 08/L-196 për pagat në sektorin publik. Në nenin 1 [Qëllimi] ky Ligj ka përcaktuar se “qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë”.

Tutje, Ligji në nenin 3 paragrafi 1 në paragrafi 1.9, ka përkufizuar pagën bazë si vijon “paga bazë – nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji;”.

Më tej, në nenin 33 paragrafi 1 të Ligjit është përcaktuar se “Nëpunëset/it në shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës dhe në kujdesin parësor shëndetësor, që ushtrojnë funksione udhëheqëse që nuk janë pjesë e shtojcave të këtij ligji përfitojnë shtesë të posaçme për ushtrimin e funksionit përkatës.”.

Gjykata konstaton se, Deklarata e përbashkët e Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, numër 122/08, datë 16.10.2008 dhe Vendimin i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me numër 05/24, datë 12.01.2018, në kohën e hyrjes së tij në fuqi ka ngritur pagat e nëpunësve të shërbimit shëndetësor. Pra, ngritja e pagave për këtë kategori është bërë me Deklaratën në fjalë dhe Vendim qeveritar, për shkak të mungesës së një ligji për pagat në sektor publik.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për pagat në sektorin publik, datë 05.02.2023, është krijuar një sistem i njëtrajtshëm i pagave në sektorin publik, ku përfshihen edhe nëpunësit e sistemit shëndetësor. Së këndejmi, me këtë ligj është përcaktuar paga bazë edhe për nëpunësit e sistemit shëndetësor, e cila i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë. Në këtë kuptim, Deklaratën në fjalë dhe Vendim qeveritar, ka zëvendësuar sistemin linear të pagave me rastin e hyrjes së tij në fuqi. Megjithatë, me hyrjen në fuqi të Ligjit për pagat në sektorin publik, është krijuar sistem i ri i pagave, ku është përcaktuar paga bazë. Andaj, duke qenë se në pagën bazë të nëpunësve të sistemit shëndetësor është përfshirë edhe kualifikimi i kërkuar për ushtrimin e funksionit, gjykata konstaton se nga provat e shqyrtuara nuk rezulton themelësia e kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimin e paditëses se me aktgjykimi në Gjykatës Kushtetuese është shpallur i pavlefshëm paragrafi 2, 3 dhe 4 i nenit 41 (shtesa tranzitore) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (shfuqizimi) i Ligjit për Pagat në Sektorin Publik dhe mbi këtë baze paditëses i takon e drejta në kompensim të shujtës mujore. Megjithatë, duke qenë se kërkesa e paditëses nuk mbështetet në një akt ligjor apo nënligjor por në një deklaratë e cila, për arsyet që u elaboruan më lartë, u konstatua se nuk prodhon efekt juridik, gjykata një pretendim të tillë e vlerëson si të pa bazuar.

Gjykata e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit në raport me të paditurën e dytë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike pasi i gjeti të bazuara kundërshtimet e Avokaturës Shtetërore të paraqitura përmes përgjigjes në padi. Nga shkresat e lëndës, vërtetohet në mënyrë të pakontestueshme se paditësi është e punësuar tek e paditura e parë SHSUK-Spitali i Përgjithshëm “Dr. Sami Haxhibeqiri” në Mitrovicë, që nënkupton se me të paditurën e dytë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, paditësja nuk ka themeluar marrëdhënie pune. Andaj, në prani të këtyre rrethanave e në mungesë të legjitimitetit real pasiv të së paditurës së parë, Gjykata në raport me të njëjtën për këto arsye, kërkesëpadinë

e paditësit e refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Duke marrë parasysh nenin 2 paragrafi 1 i LPK-ës, ku përcaktohet se “në procedurën kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”. Nga interpretimi i dispozitës së lartcekur gjykata konkludon se gjykata është e lidhur me kërkesën e propozuar nga pala ndërgjyqëse dhe rrjedhimisht gjykata nuk ka të drejtë të vendosë për diçka tjetër, që nuk është kërkuar nga pala.

Gjykata vlerëson se nga faktet e treguara në padi rezulton që palës paditëse i mungon themelësia e kërkesëpadisë në këtë çështje juridike dhe bazuar në një bindje të tillë, nuk është fare e nevojshme të caktohet seancë gjyqësore, pasi ndërmarrja eventuale e këtij veprimi nuk do të ndryshonte pikëpamjet e Gjykatës.

Vendimin që secila palë ti t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450 lidhur me nenin 452 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për faktin se pala paditëse e ka humbur kontestin gjyqësor, kurse palët e paditur, si palë gjyq fituese nuk i kanë kërkuar shpenzimet lidhur me këtë procedurë.

Vendimi që pala paditëse ti kompensoj gjykatës shumën prej 20 euro në emër te taksës gjyqësore për padi si në pikën III, në afat 15 ditor nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, gjykata e mbështeti në nenin 253 par.4 të LPK-së, e në lidhje me dispozitat e nenit 5 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të dispozitave nga nenet 160 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.3967/2024, datë 12.12.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.